



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 020-13297 dt 07.03.2018



Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 paragrafi 3 të Ligjit Nr:04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2 pika 4 e Rregullores QKR nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 27.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Më këtë Vendim formohet Komisioni Vlerësues për Dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurt në përberje prej shtatë(7) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre(3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilet i propozon Kryetari i Komunës, tre(3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend dhe një(1) anëtar ekspert nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës si vijonë:

1. Flutura Avdiu anëtare nga ekzekutivi
2. Idriz Hyseni anëtar nga ekzekutivi
3. Safet Hoxha anëtar nga ekzekutivi
4. Qendrim Mulaj anëtar nga kuvendi
5. Sabrie kukaj anëtare nga kuvendi
7. Petrit Gashi anëtare nga Kuvendi
8. Arben Kuliqi Përfaqesues (ekspert) nga shoqëria civile, Antarë

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Vlerësues janë zbatimi i procedurave sipas nenit 8 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr:04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të komunës si dhe nenit 2 pika 4 nenpikat 4.1 dhe 4.2 të Rregullores QKR nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 3

Komisioni vlerësues pas kryrjes së procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, i dërgon Kuvendit të Komunës për aprovim ofertën e përzgjedhur.

Neni 4


Mandati i këtij komisioni vazhdon deri në përfundim të mandatit të anëtarve të kuvendit

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 12 nr.942-11206 i dates 03.03.2017

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12Nr. 942 - 13294 dt 07.03. 2018

Duke u bazuar në nenin 12 nenit 40 pika 40.2 nën I të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 110 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-466-69622 të datës 17.11.2017 të komisionit mbi zbatueshmërinë e kontratave nga ana e kompanisë “Kodra” shpk nga Komorani, për Pronën Komunale të marrë në shfrytëzim të përkohshëm nga Komuna e Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më dt: 01.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR KTHIMIN E PRONËS KOMUNALE NË ZONEN KADASTRALE NË SANKOC TË CILAT I KA PASUR NË SHFRYTEZIM KOMPANIA “KODRA” SHPK KOMORAN

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonën Kadastrale në Sankoc, gjegjësisht parcelat 295/6 në sipërfaqe 5.00.00 Ha, dhe parcelën 295/7 në sipërfaqe prej 40.00.00 Ha, të cilat i ka pasur në shfrytëzim kompania “Kodra” shpk Komoran.

Neni 2

Shfuqizohen Vendimet e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe atë Vendimi 12 Nr. 465-42246 të datës 29.09.2014 dhe Vendimit 12 Nr.463-16565 të datës 25.03.2015, me të cilat vendime i është dhënë prona komunale në shfrytëzim kompanisë “Kodra” shpk Komoran fillimisht sipërfaqja sipas vendimit të parë S=5.00.00 Ha dhe me vendimin e dytë sipërfaqja prej S=40.00.00 Ha sipas afatit të shfrytëzimit afatgjatë prej 40 vitesh.

Neni 3

Pas plotfuqishmeris së këtij Vendimi (konfirmimit ligjor nga MPAL-së) obligohet kompania “Kodra” shpk Komoran që fillimisht të kryjë të gjitha obligimet, dhe në të njëjtën kohë obligohet

që të bënë lirim të siperfaqes së pronës komunale të cilën e ka pasur në shfrytëzim afatgjatë sipas kontratave, dhe atë kontratës me Nr. 01-463-54560 të datës 22.12.2014 dhe kontratës Nr.01-463-35830 të datës 10.07.2017, të nënshkruara në mes të kryetarit të komunes së Drenasit dhe përfaqësuesit të kompanisë "Kodra" shpk Komoran në afat prej 60 ditësh.

Neni 4

Pas marrjes së këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë bartjen administrative të pronës së shënuar më lart sipas nenit 2 të këtij vendimi në RDPP.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunes së Drenasit.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga data regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

 Kryetari i Kuvendit të Komunës
Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70314067-00295-7

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	Certificate draft
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	05.03.2018 - 08:53
Komuna / Opština / Municipality:	Gillogoc / Glogovac / Gillogoc
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	SANKOC / STANKOVCE / SANKOC
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Gillogoc / Glogovac / Gillogoc

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70314067-00295-7	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	400000	SIPAS KERKESE SE TERNIT MENR, 07-952-37259 ME DT. 16.07.2015	27.07.2015	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GOLESH-GOLESH/GOLESH-GOLESH-GOLESH		GOLESH-GOLESH	27.07.2015	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/Other Land	Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive		400000

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lieni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosto adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	PASURI KOMUNALE K.K. GLLOGOC	KCID914110470	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC /			1/1		27.07.2015

E. TË DREJTAT E SHFRYTËZIMIT - PRAVA NA KORISCENJE - RIGHTS OF USE

Pershkrimi i të drejtës së shfrytëzimit Opis prava koriscenja Right of use description	Emri Ime Name	Nr. personal Lieni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Residence	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosto adrese Address details	Afati dhe kushtet Rokovi i uslovi Terms and conditions	Pershkrim Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
E drejta e shfrytëzimit për kohë të caktuar / Pravo Na Koriscenje Na Određeno Vreme / Right of use for definite time	"KODRA"SHLP.K. QERAMBAJTJE PËR 40 VITE	70793547	KOMORAN / KOMORANE / KAMARAN /			5-2015	IPAS KONTRATES MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONË E PALUTSHME TË KOMUNËS, ME AFAT AFAT KOHOR PREJ 40 VITE, ME NR. 01-NR 463-35830 ME DT. 10.07.2015, SI DHE AKTVENDIMI MBI REGJITRIMIN KADASTRAL ME NR. 297/2015 ME DT. 27.07.2015	27.07.2015



Republika e Kosovës
Republica Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : "KODRA"SH.P.K. QERAMBAJTJE PËR 40 VITE

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 07-942-13326
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 07.03.2018 - 10:28
Komuna / Opština / Municipality: Glogoc / Glogovac / Glogoc
Zyra Kadastreale Komunele / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Glogoc / Glogovac / Glogoc

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA						
Mbiemri/Emri i afatizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Liteni broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistruarit Drzava državljanstva ili nkunizherja Country ofcitizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivnja Date of Birth/Establishmen t
"KODRA"SH.P.K. QERAMBAJTJE PËR 40 VITE				70793547	KOSOVA/ KOSOVA/ KOSOVO	15.11.2011
						18.05.2015

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS			
Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address
KOMORAN/ KOMORANE/ KAMARAN			

Printuar nga/Oštampani od strane/Printed by: Lirije Fazliu |

Personi/Osobu/Person: "KODRA"SH.P.K. QERAMBAJTJE PËR 40 VITE
Zgjidhjen përfaqësues / Odgovorno lice / Official person

[Signature]

E. TË DREJTAT E SHFRYTËZIMIT - PRAVA NA KORIËENJE - RIGHTS OF USE

Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Nr. i Njësise kadastrale Br. Katastarske jedinice Cadastral Unit no	Zona Kadastrale Katastarska Zona Cadastral Zone	Shfrytëzuesi Korisnik User	Lloji i njësise Vrsta Unit type	Lloji i së drejtës të shfrytëzimit Vrsta prava koriëenja Type of right use	Komentet tjera/ Ostali komentari/ Other comments	Shpërfaqja Površina Area (m²)	Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Azhuruar Ažurirano Updated
E drejta e shfrytëzimit / Pravo Na Koriëenje / Right of use	P-70314067-00295-6	SANKOC / STANKOVCE / SANKOC	*KODRAVSH.P.K QERAMBAJTJE PËR 40 VITE	parcelë / parcels / parcel	E drejta e shfrytëzimit për kohë të caktuar / Pravo Na Koriëenje Na Odròjono Vreme / Right of use for definite time	3-2015	50000	Tokë Tjetër-Jo Pjellorë- / Ostalo Zemljiste- Neplodno- / OtherLand-Unproductive	18.05.2015
E drejta e shfrytëzimit / Pravo Na Koriëenje / Right of use	P-70314067-00295-7	SANKOC / STANKOVCE / SANKOC	*KODRAVSH.P.K QERAMBAJTJE PËR 40 VITE	parcelë / parcels / parcel	E drejta e shfrytëzimit për kohë të caktuar / Pravo Na Koriëenje Na Odròjono Vreme / Right of use for definite time	5-2015	400000	Tokë Tjetër-Jo Pjellorë- / Ostalo Zemljiste- Neplodno- / OtherLand-Unproductive	27.07.2015



[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 030 - 13300 dt 07.03.2018

Në bazë të nenit 12 dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), dhe në bazë të nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës të Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt. 01.03.2018 miratoj këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2018-2020

Neni 1

Ky vendim ka për qëllim aprovimin e planit të integritetit për vitet 2018-2020 në Komunën e Drenasit

Neni 2


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zyra e Kryetarit dhe drejtoritë përkatëse profesionale të Komunës

Neni 3


Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Habinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNES



12 Nr.060-12766 dt. 05-03-2018

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
27.12.2017**

PROCESVERBAL

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më
dt.27.12.2017

Mbledhjen e kryesoi **LABINOT HALILAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 31 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Proces verbalet e dt; 31.08,19.09.dhe 07.12.2017
2. Themelimi i Komiteteve të përhershme
 - Komiteti për Politik dhe Financa si dhe
 - Komiteti për Komunitete
3. Themelimi dhe përbërja e KKSB-së
4. Propozim vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronës se -ish Kooperativës bujqësore të OP "Drenica" në Drenas (Glllogoc)

Prezentuan:Kryetari i Komunes z.Ramiz Lladrovci ,perfaqësues te KFOR-it, perfaqësues të OSCE-së dhe perfaqësues të mediave

Takimi filloi punimet në ora 13:10

LABINOT HALILAJ –përshendetje per të gjith të pranishmit,i falenderoj të gjithë për prezencen e tyre, në këtë rast kërkoj nga anëtarët e kuvendit që para se të aprovojm rendin e dites, Grupet parlamentare të japin emrat e përfaqësuesve të tyre si psh Grupi parlamentar i PDK-së e ka caktuar znj.Shqipe Zogu për kryetart të ketij grupi **SHQIPE ZOGU**-PDK-dega në Drenas më një proces të mbajtur nga anëtarët përfaqësues ne kuvendin komunal të drenasit me një vendim unanim kanë vendosur që une Shqipe Zogu të jemë përfaqësuese e Grupit parlamentar të PDK-së në Kuvend **NEXHMEDIN BALAJ**-po ashtu edhe NISMA ka mbajtur nje takim dhe unanimisht kanë vendosur që une Nexhmedin Balaj të jem përfaqësues i Grupit Nisma në Kuvend **ENDRIT GLLAREVA**-Vizioni per Drenasin ka vendosur që Xhavit Drenori të jete përfaqësues i Grupit ne kuvend

BEQIR KIQINA-AAK- në Drenas po ashtu ka vendosur që une Beqir Kiqina të jemë përfaqësues i ketij grupi ne kuvend

FLORENTINA ELEZI-VV ka vendos që Sokol Bylykbashi të jete përfaqësues i grupit parlamentar në Kuvend

LABINOT HALILAJ-atëher shkojme më votim se a jeni për këtë rend dite: Më rastin e votimit prezent ishin 31 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:31

Kunder:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e parë të rendit të dites:

1.Proces verbalet e dt.31.08.2017,19.09.2017 dhe dt.07.12.2017

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin per proces verbalin e datës 31.08.2017

pasi që nuk pati verejtje dhe diskutime rreth këti peroces verbali

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim proces verbalin e dt.31.08.2017

Më rastin e votimit prezent ishin 31 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:31

Kunder:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin per proces verbalin e dt.19.09.2017

XHAVIT DRENORI-lus sekretarine që ti bej ca permirsime ne proces ne faqen 3 dhe 4, saktesisht ne fleten nr4 kerkoj nga sekretaria që ti ndegjoj edhe njeher inqizimet pasi që nuk ka pas medium në atë mbledhje, dhe te permirsoj perfundimin e fjalimit tim kur une isha duke diskuu për qeshtjen e laptopeve, dhe në atë kohe udhëheqëse e seances ishte znj Shqipe Zogu, e cila ne mënyr autoritare më është nderprer fjalimi im dhe une në mënyr demonstrative e kamë leshu sallën.

Ne faqen nr.4 ne proces verbal kur ka filluar pjesa dyte e seances, prezent kanë qene vetem 16 anëtarë, ku shihet se parafolesit ne kete seance kane qene prezent vetem per pazaret e tyre, rast konkret kemi ish kolegun Bujar Morina ka propozu që 25 mij euro nga projekti i terstenikut II të shkojn për trotuar në fshatin Gllobarë, pa asnje arsyetim, nuk eshte shkru ne proces verbal, dhe ne anen tjeter Kryetari e ka miratu pa asnje arsyetim se keto mjete duhet me shku, dhe ketu na jep me kuptu që ajo mbledhje ka qene pune pazaresh, po jo vetem te ish kolegu Bujar Morina ,por verehet edhe te koleget tjere Bashkim Gllareve,Bujar Thaqi si dhe Haxhi Xhemajli kanë kerku që projektet e caktuara të shkojnë në fshatrat e tyre, dhe janë votu nje zeri pa asnje kundërshtim nga koleget e tyre,vet kryetari e ka pru nje propozim vendim për investin ne filan fshatin për hir te votes te nje asambleisti, dhe ka kaluar buxheti pa asnje vote kunder që do te thot që asnje faqe A4 nuk ka perfshi diskutimet per

buxhet dhe nuk kan ndodhe asnjeher pas luftes me sa kame informacione që buxheti me kalu per 15 apo 20 min.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-pasi pershendeti te pranishmit ju drejtua Xhavitit dhe tha ti je asambleist që sa koh në këtë kuvend ,e din shum mir se fillimisht hedhen ne votim propozimet e kryetarit, ne rast që miratohen nuk ka nevoj te diskutohet e nuk merren për baze propozimet e Bujarir,Gllareves apo dikujt tjeter para propozimit që une e sjell ne kuvend,me vjen shumë keq që qytetari i drenasit ta ka tregu vendin dhe edhe 4 vite e ke kështu ,dhe nese nje buxhet është aprovuar si duhet dhe në mënyr të rregullt, është ky buxhet që është aprovuar unanimsisht nga 16 anëtarët prezent që une jam mirënjohes dhe i falenderoj.

SHQIPE ZOGU-u diskutu emri im nga kolegu, por nje sqarim per qytetaret se une nuk ta kamë nderprer fjalen më menyrr autoritative por ne mënyrr procedurale pasi që ju keni dale nga rend i dites.

LABINOT HALILAJ-hodhi ne votim proces verbalin e dt:19.09.2017 me ndryshime

Më rastin e votimit prezent ishin 31 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:31

Kunder:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin per proces verbalin e dt;07.12.2017

XHAVIT DRENORI-sa i perket kesaj senace mu më është nderpre disa her fjalimi dhe nuk është regjistruar ne proces verbal,dhe kisha kerku nga proces mbajtesi te nderhyn ne kete proces verbal ,por ne kete rast:

LABINOT HALILAJ-nderhyri dhe tha,duhet kuptuar dhe dalluar procesverbalin nga transkripti sespe ne nuk kemi mundesi që të bejm transkript por ne rast se te duhet transkripti per kete mbldhje e bejm por ne proces nuk regjistrohen gjithë qka flitet ne kuvend

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim proces verbalin e datës 07.12.2017

Më rastin e votimit prezent ishin 31 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:31

Kunder:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-i njoftoj anëtarët e Kuvendit të komunës më pikën e dytë të rendit të dites:2.themelimi i komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës

-Komiteti për politik dhe financa

-Komiteti për komunitete

Duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale dhe udhëzimin administrativ komiteti për politik dhe financa duhet të ketë 7 anëtarë ku në bazë të detyres si kryesues i kuvendit janë pjesë e këtij komiteti dhe kryesoi këtë komitet, ndersa 6 anëtarët e tjerë duhet të propozohen dhe zgjidhen nga kuvendi,dhe në këtë rast unë kisha kerku që të shkojmë më propozime konkrete nga grupet, por edhe njëher per kete po ju sqaroj se me ligj per vetqeverisje lokale dhe me udhezim Administrativ Nr.03/2014 Kuvendi i Komunës ka per obligim themelimin e ketij komiteti dhe perberja e keti komiteti përbehet prej 7 anëtarve ku antari i 7 do te jemi une si kryesues i ketij komiteti dhe ne kete rast ne na mbetet që te shkojme me propozime:

XHAVIT DRENORI-une kisha kerku sqarime rreth komitetit per Politik dhe Financa ,kame kerku edhe nge MAPL-ja dhe deri ne vitin 2014 KPF-ca është themelu sipasi nenit 51 dhe 52 të ligjit per vetqeverisje lokale, ndersa ne vitin 2014 është nxjerr edhe nje udhezim Administrativ ku specifikon përberjen dhe themelimin e ketyre

komiteteve dhe kuart e ka sqaru udhezimi se si ndahen mandatet dhe ne këtë rast mandatet ipen sipas përqindje se votave që ka shpall KQZ-ja e jo dikush ti merr 6 mandate e dikush asnje ju kisha lutur të respektohet ligji dhe udhëzimi administrativ **LABINOT HALILAJ**- nderhyri,dhe ju drejtu, Xhavit mos paragjyko se ne ende nuk kemi hy ne votim, mund të ndodh që nuk propozojm asnje kandidat

XHAVIT DRENORI-nuk po paragjykoj, po kerkoj që të respektohet udhezimi Administrativ sepse shumë mir e specifikon themelimin e ketij komiteti ku duhet të perfshihen të gjitha entitetet, por ne rast se ka më shume entitete themelimi behet sipas perqindjes se votave, dhe ne kete rast une mendoj që PDK-ja duhet ti kete 3 anëtarë dy(2) nga kuvendi, dhe ju Kryesues shkoni sipas detyre,pastaj Nisma- me kandidatin e vet nese mendon që duhet ti kete me teper ateher mund te propozoj,pastaj Vizioni per Drenasin dhe partit tjera me radhe deri ne plotesimin e ketij komiteti, dhe mir ka qenë që të kete nje ujdj që procesi të shkoje mirë.

LABINOT HALILAJ-une kisha kerku që të shkojme me propozime

SOKOL BYLYKBASHI-ne këtë rast ne duhet të jemi parimor, gjithperfshirës dhe ti permbahemi nje betimi që e kemi dhënë, në këtë rast kemi të bejm më themelimin e dy komiteteve të perhershme të kuvendit të Komunës: Komitetitn për Politik dhe Financa dhe Komiteti per Komunitete dhe kur është fjala per K.P.Fca ky komitet ka rendesi të veqant, une mund ta quaj edhe si nje lloj kryesie dhe kjo qeshtje është e rregulluar me dy akte normative Ligji per vetqeverisje lokale dhe Udhhezimi Administrativ,me ligj percaktohet shume mir se ne kete komitet duhet të perfshihen të gjitha entitetet që kane perfaqësim ne kuvend,po ashtu kemi edhe nje udhezim administrativ i cili percakton proceduren e themelimit, përberjen dhe kompetencat e ketij komiteti e qe specifikohen ne nenin 6 pika 1 dhe 2 e keti udhezimi ku përberja e ketij komiteti duhet të reflektoj përfaqesimin e entiteteve politike si dhe numrin e ulseve nga entitetet politike të perfaqësuar ne kuvendin e komunes,por ne rast se ne kuvendin e komunës janë me shume entitete politike me qka e bejnë të pamundur perfrshirjen e të gjitha entiteteve ne KPF-ca, ateher perfaqësimi do te behet me nje renditje te subjekteve politike duke marr numrin me ta madhe të perfaqësusesve ne kuvendin e komunes, dhe ne kete rast kryesuesi i kuvendit nuk mund te kerkoj hajt të shkojm me propozime, kush kë do me propozu, por mund te shkojm me propozime duke respektu radhitjen sipas grupeve parlamentare pozit dhe opozit duke filluar nga PDK-ja Nisma Vizioni VV e keshtu me radhe .

LABINOT HALILAJ-ne dje e kemi mbajtur një takim me perfaqësues të grupeve të opozites më qëllim të arritjes se një koncensusi por ju jeni ata që nuk keni pranuar dhe i keni perjashtuar nga takimi kolegt e juaj ne ju kemi ftu në takim për këtë qëllim

SABRIJE KUKAJ-kerkoj që ky komitet të zgjidhet sipas votave të fituara në kuvend,në këtë rast 3 anëtarë i takojnë pdk-së,2 anëtarë nismes pasi që kemi ma teper vota se sa te gjitha partitë tjera opozitarer,ndersa anëtaaret tjerë vinë sipas radhes dhe votave të fituara.

PETRIT SINANI-është në interesin e të gjidhve që ta zgjedhim këtë Komitet dhe sa më denjesisht sepse nuk kanë rendesi shumë qeshtjet partijake, sa ka rendesi qeshtja për interes të qytatarve,për here të parë në jeten time kam ndjer veten të privilegjuar, ku kolegët tonë nga opozita kishin thirrur nje takim gjë që është normale dhe nuk jemi ftuar, përderisa ne nuk kemi nderruar ose nuk kemi dalur dikun tjetër ne jemi parti opozitare,pasi që MAPL-ja e monitoron punën e kuvendit dhe janë ligjet dhe aktet tjera nënligjore që e rregullojne punen e kuvendit, nuk mendoj që i prish punë zgjedhja e ketij komiteti dhe komiteteve tjera,është mirë që të shkojm më propozime dhe ata që janë më shumic votash të jenë anëtarë të ketij komiteti se kjo është mënyra demokratike e zgjedhjes, dhe nuk ka logjikë që dikush të jete pjes e ketij

komiteti nese nuk i merr votat shumicë, shkojm më propozime, të gjitha entitetet kanë të drejt me propozu, Udhëzimi është një akt nënligjor nuk është ligj ,dhe askund nuk thuhet obligohet por duhet të reflektoj gjë që u jep mundesi të gjitha partive që ti japin propozimet e tyre,ne rast se do të kete shkelje gjatë zgjedhjes se ketij komiteti është organi vendimarrës që mërret me kete qëshetje.

BEQIR KIQINA- Kuvendi përbehet prej 31 anëtarëve,dhe sipas ligjit dhe udhëzimit Administrativ duhet të reflektoj në mënyr pozitive pasi që ne si komunë sipas udhëzimit dhe ligjit na lejohet që ky komitet të perbehet prej 7 anëtarve dhe duhet të veprojm sipas ketij udhezimi, të veprojm sipas përqindje së votave duke filluar nga partia më e madhe që është shumicë ne kete rast Pdk-ja që ka fituar 46 % të votave, por nuk ka marrë 51% të votave që te kete më shume se 3 antarë,kisha dashtë të ndalem edhe të subjektet tjera e që ketu nuk janë 7 por janë 9 subjekte, kjo shkonë në bazë te rezultatit zgjedhorë e jo nje subjekt që ka vetem nje perfaqësues të marre nje vend ne kete komitet para atyre që kane 2 apo 3 përfaqësues në kuvend prandaj janë dy gjera që dua ti cekë:

- 1.Ligji për vetqeverisje lokale si dhe
- 2.Udhezimi Administrativ ,une dua të ndalem në këtë udhëzim administrativ neni 6 pika 1 ku përberja e ketij komiteti duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike si dhe numrin e uleseve nga entitetet politike të përfaqësuar ne kuvendin e komunes ,e që ne kete rast partia demokratike duhet të perfaqësohet me 2 anëare + kryesuesi 3 pastaj Nisma duhet të kete perfaqësusein e vet,Vizioni per Drenasin,VV si dhe AAK -ja dhe kjo është zgjedhja më e mir mendoj une që pastaj të mos kemi probleme në të ardhmen,dhe kisha kerku që pozita mos të perzihet ne punet e opozites dhe as opozita ne punet e pozitës dhe ta zgjedhim këtë problem.

LABINOT HALILAJ-perseri kerkoj nga anëtarët e Kuvendit që të shkojmë më propozime

BEQIR KIQINA-kerkoj që të respektohet ligji dhe udhëzimi administrativ

NEXHMEDIN BALAJ-kerkoj që të kemi një qelës paraprakisht e të mos ngutemi më propozime duhet të specifikohet nga sa anëtarë duhet të kenë partitë

BEDRI NIKA-sa i perket komitetit për politik dhe financa ligji shumirë e sqaron se në komitet duhet të perfshihen të gjitha entitetet se përfaqësim ka edhe LDK-ja këtu, shumic jemi edhe ne 4 anëtarë te partive të ndryshme që kemi perfaëqsim në kuvend me nga një anëtarë,LDK.AKR,IQD vimë ne radhe para partive tjera se jemi 4 anëtarë, dhe pastaj vine Vizioni ,VV dhe AAK-ja dhe kemi të drejtë me u propozu,dje ishin të thirrur në nje takim Vizioni VV dhe AAK-ja dhe ne këtë rast i kishin perjashtuar koleget e tyre nga ky takim dhe përfaqesimi në këtë komitet na takon te gjithëve ,unë kisha kerku që të shkojmë më propozime,hidhen në votim propozimet dhe vazhdojmë më procedurat tjera, ne pas partis më të madhe ne jemi shumic këtu, sepse jemi 4 anëtarë dhe nuk e specifikon as ligji e as udhezimi që të kete nje qelës se kush duhet të përfaqësohet ne kete komitet po pas partis me të madhe jemi ne me 4 anëtarë, ndersa vin partit tjer më radhe, e që po thirreni ne opozit asgje nuk keni ber ju si opozit deri me tani, dhe qytetaret ju kanë tregu vendin andaj të shkojm më propozime jemi nder partit më të vjetra dhe kemi nje pervoj ne kete drejtim dhe jemi më ta dishem se sa partit e tjera

SOKOL BYLYKBASHI-sa i perket parafolsit të LDK-së po ja bej me dije se kuvendi nuk është vend ku behet biznesi e as tregtia e as shkëmbim të monedhave.e dyta sa i perket menyres së votimit propozime nuk mund të kete qdo kush,propozimet duhet të shkojn pako dhe të votohen sipas renditjes dhe uleseve në kuvend , e jo nje individ të propozohet dhe mund ti merr votat para atyre që kanë më shum se dy apo tre anëtar në kuvend, udhezimi e specifikon shumë mirë se ne komitet duhet të perfaqësohemi

sipas ulëseve që kemi ne kuvend, dhe votimi duhet të behet ne pako ne menyre që të mos eliminohen ata që u takoj vendet aty

XHAVIT DRENORI-nuk e mendova që duhet me debatu me grupet tjera opozitare, po me që u zu emri im ne goje,të dy kandidatet edhe nga petriti AKR-ja edhe nga LDK-ja edhe une pajtohem më parafolsin që nese kuvendi e ka pa për me ardh me fole me banë pazare të biznesev psh.per byfet ne parlamentin e kosoves, nese është aq ne zor po ja dhe une votat e mija dhe let ta merr at vend dhe le të kryhet dhe të zgjedhim nje problem ,mos të lam probleme të pa zgjdhura,kolegu që koka ndi keq, kolegun nuk e di kush e ka ftu ,po ftesen une kam të drejt me e ftu Kryesuesin si grup paralamentar me u taku dhe ju keni qen musafir të pa ftuar në atë takim

LABINOT HALILAJ- nderhyri kryesuesi ata nuk kan qene musafir ata kanë qenë te ftuar nga kryesuesi i kuvendit të Komunës

XHAVIT DRENORI- Po ju lus që të mos bejm teater dhe të shkojm në bazë të udhezimit administrativ që e sqaroj edhe kolegu nga Aleanca të ndahet qelësi i mandateve sipas ligjit dhe udhezimit administrativ une jam ketu per ti mbrojt interesat e qytetarve dhe ligji qetu nuk ka me u shkel, nuk lejoj, pazargjitë e kane vendin ne kafe e jo në kuvendin komunal

BEDRI NIKA-biznes kamë banë edhe me heret, po beje edhe tash dhe biznesi është i ndar nga politika, por keta dy anëtarë janë të pa dinjitetshëm dhe të pa pergjegjshem, sepse nuk kanë argument me dokumentu nje kërkes të tyre të pa bazuar, prandaj une dua të ju them dy kolegeve nuk duhet të merren me biznesin tim, se une merrem me politik dhe dua të punoj per politiken dhe ne interes të qytetarve, dhe nuk dua të merrem me ta dhe ne kete rast kerkoj nga kryesuesi që të hidhet ne votim propozimi dhe te mos merremi me keto qeshtje sepse kemi kohe mjaft per tu marr me keto qeshtje .

PETRIT SINANI-kur po ndegjoj fyrtje prej nje kolegu asambleist me vjen keq por keta masin me kanar të vetin,ketu nuk eshte vend pazaresh, po ne jemi kuvend dhe kemi kohe 4 vite me e deshmu veten para qytetarve dhe një dua të thëmë se nese dikush bene teater ne kuvend është vet drenori aktor deshtak ne këtë kuvend.

XHAVIT DRENORI-kërkon replike për fyrtjen që ju është bere nga z.Sinani.....

PETRIT SINANI- deshtak nuk është fyrtje ...

PETRIT GASHI-edhe ligji edhe rregullorja po edhe udhëzimi e thot qart se duhet të reflektojnë entitetet politike, e keto subjekte duhet te kene nje ujdj dhe të merren vesh se si duhet të perfaqësohemi,ndersa nese i bejn pazaret siq i kanë berë mbrem atëherë le të vazhdojnë, dhe nuk duhet të përjashtohet askush se të gjithë kemi të drejt të propozohemi dhe kush do që merr vota më se shumti le të shkon,dhe kisha kerku nga kryesuesi që të shkojm më propozime

SOKOL BYLYKBASHI-une dua të permendi dy qeshtje entitetin dhe reflektimin,reflektimi është pasqyrim i gjendjes faktike, ndersa entitet llogaritet nje marrveshje paraprake e nje anëtarit ose disa anetarve për të kaluar ne një subjekt tjeter politik, por kjo duhet të ndodhe me nje marrveshje me shkrim dhe paraprakisht.

BEQIR KIQINA-z.Nika me heret apostrofoj subjektin tim politik se ka renje po sa për sqarim po i tregoj z.Nika se AKK në drenas ka rritje,po po të tregoj z.Nika se ty ta ka tregu vendin qytetari se menzi je hy ne kuvend

XHAVIT DRENORI-une jam i lumtur që ka opozit dhe edhe njeher kisha kerku që të reflektojm sipas votave që kemi fituar ne kuvend të respektohet ligji dhe udhëzimi administrativ

SABRIJE KUKAJ-une kisha thanë që të shkojm me propozime dhe sipas votav që kemi fituar ne kuvend PDK-duhet ti ketë 3 anëtar se bashku me Kryesuesin,NISMA

2 anëtarë pastaj me një anëtar vinë VIZIONI,VV dhe AAK-ja let të merren vesh për keta dy anëtarët tjer

LABINOT HALILAJ-kërkoj nga gjitha grupet që të shkojm më propozime konkret me anëtarë nga Grupet Parlamentare

LABINOT HALILAJ-a ka ndonje propozim, shkojmë më propozime:

Shqipe Zogu - Grupi parlamentar i PDK-së propozon dy anëtarë për Komitet per Politik dhe Financa

1.Gani Podrimqaku dhe

2.Blerina Gashi

Nexhmedin Balaj -nga NISMA- propozoj dy anëtarë

1.Burim Bujupi dhe

2.Arigon Sinani

XHAVIT DRENORI- e falenderoj shafen e grupit te PDK-së për propozimet që i dha dhe ne këtë rast nyja është zgjidhe ,por nuk pajtoj më atë që Nisma për Kosoven ka propzuar dy kandidatë sepse ne dje ishim dakordu që të kemi nga një perfaqësuse ne K.P.F-ca sipas renditjes se subjekteve politike

LABINOT HALILAJ- kerkoj nga xhaviti urdhro nese ke ndonje propozim :

XHAVIT DRENORI- përseri kërkoj që para se të shkojm më propozime të na jep 10 min pushim në menyrr që të merremi vesh se si te veprojmë ,une po them së secili grup që ka fitu me tepër se 1 kandidat duhet të kete përfaqësim ne K.P.F-ca ,undhezimi e thote qartë se ne kete rast Nismes i takon një,Viziononit një VV një si dhe AAK-së një kandidatë

BEQIR KIQINA-ende nuk janë pjekur procedurat për të vazhduar më propozime

Florentina Elezi - nga levizja VV propozon:

1.Sokol Bylykbashin

Edolina Plakiqi -nga AAK propozon:

1.Beqir Kiqina

Bedri Nika propozon: kandidatin e pavarur Hamit Kastrati

Petrit Sinani -propozon: Bedri Nika nga LDK-ja

Hamit Kastrati -Propozon: Petrit Gashi nga IQD

Endrit Gllareve -nga Vizioni për Drenasin propozon Xhavit Drenorin

LABINOT HALILAJ- kërkoj 10 min pauzë pasi që janë më teper se 6 propozime dhe ndoshta mund të arrijmë një konsensus dhe në këtë rast kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që të japin kontributin e tyre dhe nese ne arrimë që 6 prej ketyre anëtarve të jenë pjesë e ketij Komiteti, nuk kemi nevojë që të shkojmë me votim të mbyllur, prandaj unë kisha kerku të arrihet një marrveshje, une jam që të respektohet ligji dhe Udhezimi nese dikush mendon që ka shkelje janë organet që merren me kete qështje, por une dua që ky vendim dhe ky komitet të themelohet ashtu siq është më së miri gjithëher në repektim të ligjit dhe udhëzimit administrativ

SHQIPE ZOGU- ne si parti demokratike kemi reflektuar në baza ligjore dhe respektu kuoten gjinore ,kemi propozu një mashkull dhe një femer, por ne këtë rast kerkoj nga opozita që kandidaturat e propozuara që janë vetem meshkuj ti terheqin dhe të propozojnë femra në këtë komitet se ne të kundertën MAPL-ja do të na kthej këtë vendim edhe një here për shkak të mos respektimit të kuotes gjinore.

BURIM BUJUPI-Nisma duhet të vi më dy kandidatë,pasi që i kemi edhe votat më shumë se sa të gjitha partitë tjera opozitare

LABINOT HALILAJ-këtu shihet se nuk respektohet ligji nga opozita, sidomos barazia gjinore ku asnjë anëtar nuk e kemi të gjinis femrore, përveq PDK-ja që e propozoj kandidaten e vetë, une perseri kërkoj që të arrijm një marrveshje,a ka prej subjekteve

opozitare ndonje emer të gjinis femrore për propozim, në këtë rast keni 10 minuta pauzë:

LABINOT HALILAJ- pas kthimit nga pauza kërkoj nga anëtarët e kuvendit që të vazhdojmë më senacën ku prezent janë 30 anëtarë dhe në këtë rast i njoftoj me propozimet e dhena të anëtarëve nga grupet parlamentare, dhe pasi që janë të propozuar më tepër se 6 anëtarë dhe nuk arrihem një koncensus, ne duhet të shkojmë në votim të mbyllur, por duhet të zgjidhet paraprakisht një komision prej 3 apo 5 anëtarëve për numrim të votave

XHAVIT DRENORI-z.Kryesues po e shkelni ligjin

LABINOT HALILAJ-ju nuk mund të konstatojmë se ne po e shkelim ligjin, ne jemi duke vepru sipas ligjit

SHQIPE ZOGU-perderisa e kemi një listë më tepër se 7 numra ne nuk mund të votojmë pako dhe automatikisht duhet të shkojmë me procesin të mbyllur dhe ata që marrin më së shumti vota shkojnë në Komitetin për Politikë dhe Financa

SOKOL BYLYKBASHI-une kam vetëm një pyetje për shqipërinë dhe për ju Kryesues, qka nëse une jam i pavarur dhe kam vetëm 300 vota jam i mirë dhe me perkrashin po qka me bane ata që janë me 2 apo 3 ulse në kuvend se ato janë vota dhe nuk janë hajgare, kur kemi mbërritur numrin 7 është dashtë me u nderpre propozimet sipas renditjes së subjekteve politike dhe nuk ka pas nevojë me shku me shumë propozime.

LABINOT HALILAJ- sa i përket pazarit dhe shkeljeve të ligjit, ju jeni ata që po e shkelni ligjin përveq grupit parlamentar të PDK-së, a e respektum kuotën gjinore, a e thate që ne me i propozu dy i propozum, ne e respektum edhe ligjin për numrin e anëtarëve edhe kuotën gjinore, ku jeni ju që po e respektoni ligjin.

NEXHME DIN BALAJ-une mendoj se në këtë rast PDK-ja e ka kryer punën e vet dhe tash kisha kerku që opozita të merren vesh dhe të bëjmë zgjidhje për 4 vende të mbetura ne duhet të merremi vesh

XHAVIT DRENORI-une pajtohem më atë që partia me e madhe ka reflektuar në këtë rast edhe tek numri i anëtarëve dhe tek kuota gjinore, por problemi është tek qelsi dhe tash është qeshtja problemi të opozita është fjala të 4 numrat se kush duhet të jete në këtë komitet, une edhe një herë po e perseris nënën 6 të udhëzimit administrativ se si e rregullon këtë qështje ku reflekton përfaqësimin e entiteteve politike sipas numrit të ulsëve pra sipas numrit të votave të fituara, e jo të zgjidhet një anëtar tjetër që është i vetëm dhe ka më pak vota, sepse në këtë rast bëjmë shkelje të ligjit dhe udhëzimit administrativ dhe MAPL-ja këtë vendim do të na kthejë prapë në ryshqyrtim, prandaj kisha kerku që të respektohet ligji dhe udhëzimi administrativ

LABINOT HALILAJ- ju qysh në fillim paragjykontë se PDK-ja mundet me bane këtë apo atë, dhe perseri po paragjykoni dhe sa e shoh une krejt këto diskutime kanë boshë, por une kërkoj që të vazhdojmë me punën në kuvend dhe të shkojmë në votim për votim të mbyllur:

Me rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për:21

Kundër:01

Abstenim:01

LABINOT HALILAJ-kërkoj që të shkojmë me propozime konkrete për zgjedhjen e komisionit prej 3 anëtarëve dhe në këtë rast më shumicë votash u votua për formimin e këtij komisioni:

Shqipe Zogu -Propozon Qendrim Mulaj

Nexhmedin Balaj- propozon Vehbi Berisha dhe

BEDRI NIKA –per antar të ketij komisioni propozon Petrit Sinani

XHAVIT DRENORI-leshon sellen në mënyr demonstrative se bashku me anëtarët tjerë të Vizionit për shkak se po shkelet ligji

SOKOL BYLYKBASHI- gjithashtu leshon sellen se bashku me antaren tjetër të ketij subjekti politik për shkak se po shkelet ligji

BEQIR KIQINA - gjithashtu leshon sellen se bashku me antaren tjetër të ketij subjekti politik

LABINOT HALILAJ-kërkoj që të shkojmë më një pauze 5 min derisa komisioni të i përgadit fletëvotimet

QENDRIM MULAJ-ne emer te komisionit deklaroj se prezent ne salle janë 23 anëtarë,i njoftoj antaret e kuvendit me procedurat e votimit dhe ne kete rast i ftoj anëtarët e kuvendit një nga një për te marre fletvotimin per te votuar :

Komisioni pas perfundimit të votimit dhe numrimit të votave konstatoj se anëtarët e ketij komiteti u zgjodhen si:

-Gani Podrimqaku

-Blerina Gashi-

-Burim Bujupi

-Hamit Kastrati

-Bedri Nika dhe

-Petrit Gashi

LABINOT HALILAJ-kerkoj nga anëtarët e kuvendit që të formohet edhe Komiteti per Komunitete dhe në këtë rast sipas Udhezimit lejohet që komiteti ti kete 5 deri 9 anëtarë,por ju nese pajtoheni une propozoj që ky komitet ti kete 9 anëtarë dhe në këtë rast hodhi ne votim propozimin:

Me rastin e votimit prezet ishin 23 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:20

Kundër:03

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-i njoftoj anëtarët e kuvendit se ky komitet duhet të perfshihet me 5 anëtarë nga Kuvendi,ndersa pjesa tjetër plotesohet me anëtare të Komuniteteve jashe kuvendit dhe ne kete rast kerkoj nga anëtarët e kuvendit që të shkojne me propozime konkrete

SHQIPE ZOGU- ne emer te Grupit Parlamentar të PDK-së propozoj

Bekim Lestranin,Kimete Bardhi si dhe Malsore Cakiqi ,Nisma Propozon Vehbi Berisha dhe Arigon Sinani

LABINOT HALILAJ- hodhi në votim propozimet për formimin e ketij komiteti:

Me rastin e votimit prezet ishin 23 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:23

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin per piken e tret të rendit të dites

3 Themelimi dhe përbërja e KKSB-së

VEHBI BERISHA-propozoj që në këtë këshill të perfshihet edhe me një perfaqësues KVRL-ja:

LABINOT HALILAJ- hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites më plotesim edhe më një anëtar nga KVRL-ja

Me rastin e votimit prezet ishin 23 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:20

Kundër:03

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e katërt të rendit të dites

4.Propozim vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronës së -ish Kooperativës bujqësore të OP "Drenica" në Drenas (Glllogoc)

MILAIM HAJDARI-dha nje arsytim rreth ketij propozim vendimi,deklaroj se është ne interes të përgjithshem dhe për komunën pasi që kjo pronë është nen menagjim të AKP-së dhe kjo pronë të kthehet nen menagjim të komunës, në këtë rast kisha kerku nga ju që ky propozim vendim të hidhet ne votim dhe të kaloj .

SOKOL BYLYKBASHI-sa i perket kesaj pike nje gjë duhet ta kemi të qarte se nuk duhet të perzihen seancat konstituive me ato të punës,mbledhja e sotme ka më shumë karakter konstituiv sepse po themelohen dy komitetet e perhershme që janë obligative dhe kjo pike duhet të kaloj nëper mes K.P.F-ca e pastaj të vije ne kuvend se po bejm shkelje

MILAIM HAJDARI-po ju njoftoj i nderuari antarë i kuvendit dhe gjith anëtarët tjere se qëllimi i ketij propozim vendimi është që ajo prone që menagjohet nga AKP-ja të kthehet në prone komunale në mënyr që të mos shitet sepse është ne interes të qytatarve të komunës tone për atë edhe e kemi pru ne kuvend

SOKOL BYLYKBASHI-drejtor une fola për anën procedurale të mbledhjes që është mbajtur sot, nuk fola për rëndësin e keti, se e dimë të gjithë qfar rendesie ka, se ka të bej me prona, por vetem duhet dalluar mbledhjet konstituive prej mbledhjeve të punës sepse kjo pike është dasht të kaloj nëpermes K.P.F-ca për kete e pata fjalen.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-sokol ne jemi mundu më e banë një zgjidhje, ne asnje rregullore nuk shkrun qe na nuk mundemi ne këtë mbledhje me e shti edhe pika tjera të rendit të dites,une jamë plotesisht dakord për me e tërheq këtë pikë të rendit të dites, nese pajtoheni ju asambleistat por ju nuk e kërkuat më e tëhreq kur u miratu rendi i dites dhe këkroj nga Kryesuesi me e tërheq këtë pikë të rendit të dites nese ju e vlersoni për me tërheq kete pike

LABINOT HALILAJ-më kerkesen e kryetarit kërkoj që kjo pikë e rendit të dites të shtyhet per seancen e radhes

Me rastin e votimit prezet ishin 30 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:26

Kundër:0

Abstenim:04

LABINOT HALILAJ- mbylli këtë seancë rreth ores:16 e 30 minuta

Proces mbajtësi

Xhavit Nebihi



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj